I Dërguari i Allahut e madhëronte Allahun me këto fjalë pas çdo namazi (farz)

Ebu Zubejri tregon: Ibn Zubejri (Allahu qoftë i kënaqur me të!), pas çdo namazi (farz), pasi jepte selam, thoshte: "S'ka të adhuruar me të drejtë përveç Allahut, që është Një dhe i Pashoq. Atij i takon sundimi e lavdia dhe Ai është i Plotfuqishëm për çdo gjë! S'mund të bëhet asnjë lëvizje dhe nuk ka fuqi për asgjë pa ndihmën e Allahut! S'ka të adhuruar me të drejtë përveç Allahut dhe nuk adhurojmë asnjë tjetër përveç Tij! Dhuntitë dhe mirësitë janë prej Tij dhe vetëm Atij i takon lavdi më i bukur! S'ka të adhuruar me të drejtë përveç Allahut! Adhurimin e kryejmë me sinqeritet vetëm për Të, edhe pse këtë e urrejnë jobesimtarët!" Abdullah ibn Zubejri thoshte: "I Dërguari i Allahut e madhëronte Allahun me këto fjalë pas çdo namazi (farz)."

[Sahih] [Transmeton Muslimi]

I Dërguari i Allahut e madhëronte (Allahun me) këtë dhikër madhështor pas selamit të çdo namazi farz dhe kuptimi i tij është: "S'ka të adhuruar me të drejtë përveç Allahut", respektivisht nuk ka zot që meriton të adhurohet pos Allahut. "që është Një dhe i Pashoq", respektivisht Ai nuk ka ortakë në adhurimin, zotërimin dhe emrat e cilësitë e Tij. "Atij i takon sundimi", respektivisht Atij i takon sundimi absolut, i përgjithshëm e gjithëpërfshirës, sundimi i qiejve e i Tokës dhe i gjithçkaje që gjendet ndërmjet tyre. "dhe lavdia", respektivisht Ai përshkruhet me përsosuri absolute, i lavdëruar me përsosuri nga dashuria dhe madhërimi në të gjitha rrethanat, në mirëqenie dhe në gjendje të vështirë. "Dhe Ai është i Plotfuqishëm për çdo gjë!", pra fuqia e Tij është e përkryer dhe e plotë në çdo aspekt, asgjë nuk mund t'i shpëtojë Atij dhe asgjë nuk është e pamundur për Të. "S'mund të bëhet asnjë lëvizje dhe nuk ka fuqi për asgjë pa ndihmën e Allahut!" Pra, nuk ka ndryshim nga një gjendje në tjetrën, ose nga mosbindja ndaj Allahut në bindje ndaj Tij, e as fuqi, përveçse me Allahun, sepse Ai është Ndihmësi dhe tek Ai mbështetemi. "S'ka të adhuruar me të drejtë përveç Allahut dhe nuk adhurojmë asnjë tjetër përveç Tij!", vërtetim i kuptimit se Ai është i denjë për adhurim dhe vërtetim i mohimit të idhujtarisë, dhe se askush nuk meriton të adhurohet përveç Tij. "Dhuntitë dhe mirësitë janë prej Tij", Ai është që i krijon dhe i posedon dhuntitë dhe ia dhuron kujt të dojë nga robërit e Vet. "dhe vetëm Atij i takon lavdi më i bukur!", për Qenien, cilësitë, veprat dhe dhuntitë e Tij, si dhe për çdo gjendje. "S'ka të adhuruar me të drejtë përveç Allahut! Adhurimin e kryejmë me sinqeritet vetëm për Të", pra, duke e veçuar Atë me adhurim, e jo për syefaqësi e prestigj. "edhe pse këtë e urrejnë jobesimtarët!", pra, jemi të qëndrueshëm në veçimin e Allahut në adhurim, edhe pse këtë e urrejnë jobesimtarët.